

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-158/14

**Prishtinë
5 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

S. G.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA27005) i datës 27 Nëntor 2013 pas shqyrtimit të mbajtur më 5 Tetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S. G. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013 të datës 27 Nëntor 2013.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/223/2013 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA27005), i datës 27 Nëntor 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 2 Shkurt 2007 S.D. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr 360 me sipërfaqe prej 00.24.42 ha, në Zonën Kadastrale të Miradi e Epërme/Gornje Dobrevo, Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ai pretendon se babai i tij M. G. ka paguar edhe një vlerë monetare për truallin dhe prona është humbur në Qershor të vitit 1999.
2. Paraqitësi i Kërkesës bashkë me kërkesën ka paraqitur edhe këto dokumente:
 - Vendimin mbi Ndarijen e trollit Nr 170 i datës 2 Prill 1975 me të cilin paraqitësit të kërkesës i ndahet nga Ndërmarrja Shoqërore, trualli në sipërfaqe prej 00.08.00 ha pa specifikuar ngastrën.
 - Fletën poseduese nr. 168 të lëshuar nga Enti i Gjeodezisë dhe Kadsatrit në Prishtinë-dega në Fushë Kosovë/Kosovo Polje që dëshmon se prona e kërkuar është e evidentuar si pronë Shoqërore e Ndërmarrjes Industriale Bujqësore "Kosovo Eksport" nga Fushë Kosova/Kosovo Polje.
 - Pëlqimin Nr 139 i datës 23 Mars 1993 të lëshuar nga Ndërmarrja Shoqërore "Gornje Dobrevo" që dëshmon se Ndërmarrja Shoqërore ka dhënë pëlqimin për regjistrimin e pronës në kadastër në emër të paraqitësit të kërkesës

- Vendime të ndryshme që dëshmojnë se paraqitësi i kërkesës ka paguar taksa për pronën para konfliktit të armatosur.
 - Zyrtarët e AKP-së *ex officio* kishin siguruar vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore HPCC/D/177/2005/C të datës 29 Prill 2005 me të cilin përmes Urdhërit Deklarativ ishte vërtetuar se prona ishte shkatërruar dhe se në ditën e shkatërrimit paraqitësi i ankesës i ka plotësuar kushtet për kthim të posedimit.
3. Identifikimi i pronës së kërkuar është bërë më 1 Shtator 2008 dhe gjatë procesit të identifikimit është gjetur se prona banesore ishte e shkatërruar kurse trualli është i zënë nga H.N. i cili me 11 Janar 2008 e ka nënshkruar njoftimin për pjesëmarrje duke mos kërkuar të drejta ligjore mbi pronën.
 4. Askush nuk ka marrë pjesë në procedurë pranë AKP-së.
 5. Dokumentat e parashtruara nga paraqitësi i kërkesës ishin verifikuar pozitivisht. AKP-ja e ka siguruar *ex officio*, Certifikatën e Pronësisë të datës 17 Janar 2013 me të cilën dëshmohej se prona e kërkuar është e regjistruar në emër të K.B.I "Kosova Export".
 6. Paraqitësi i kërkesës ishte kontaktuar nga AKP-ja më 20 Janar 2009 dhe më 29 Shtator 2009 duke u pyetur për dokumenta shtesë me të cilat do të dëshmonte pronësinë por në afatin e caktuar ai ka sjellë dëshmi se ka paguar taksën mbi pronën dhe marrëveshjen tripalëshe mes Komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Paraqitësit të Kërkesës dhe Organizatës Humanitare për Rindërtimin e shtëpisë.
 7. KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën me vendimin KPCC/D/R/223/2013 të datës 27 Nëntor 2013. Në paragrafët 50 dhe 51 të vendimit grupor thuhet se kërkesa duhet refuzuar, sepse paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregoj se ka pasur të drejtë pronësie mbi pronën e kërkuar dhe se e njëjta është pronë shoqërore e dhënë në shfrytëzim. Sipas mendimit të komisionit Pëlqimi për Regjistrim dhe Vendimi mbi Ndarjen nuk janë dëshmi të mjaftueshme që të provojnë pronësinë e pretenduar.
 8. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (në tekstin e mëtutjeshëm: Palës Ankuese) më 20 Mars 2014. Ai ka paraqitur ankesë në Kolegjin e AKP-së të Gjykatës Supreme më 17 prill 2014.

Pretendimet e palës ankuese

9. Pala Ankuese kërkon që Gjykata Supreme e Kosovës që ta ndryshojë vendimin e KKPK-së, ta rishikojë dhe t'ia njoh të drejtën në shfrytëzim të pronës banesore sepse ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme. Në atë truell ai pohon se babai i tij me mjetet e tija ka ndërtuar objektin banesor dhe pas vdekjes së tij ai ka jetuar i papenguar në atë shtëpi deri në Qershor të vitit 1999. Prandaj i kërkon Gjykatës Supreme që të marr vendim me të cilin i kthehet posedimi mbi pronën e kërkuar.

Arsyetimi ligjor

10. Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
11. Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi se vendimi i ankimuar i KKPK-së kishte bërë vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, dhe mbi atë bazë edhe e drejta materiale edhe e drejta procedurale janë zbatuar si duhet. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.
12. Për sa i takon pretendimit të Palës Ankuese sipas të cilit me Vendimin për Ndarjen e pronës i është ndarë truall në shfrytëzim në sipërfaqe prej 00.08.00 ha pa specifikuar numrin e ngastrës, Gjykata Supreme konstaton gjithashtu se kjo e drejtë e shfrytëzimit nuk është dhënë për pronën private. Nga dokumentet e prezantuar nga Pala Ankuese rezulton që Ndërmarrja Shoqërore ishte pronare e palujtshmerisë.
13. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, b) kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, ku paditësi për të dyja kategoritë nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat të tilla pronësor

14. Për arsye se kërkesa nuk ka të bëjë me pronën e paluajtshme private, KKPK nuk ka pasur juridiksion të vendos lidhur me këtë kërkesë. Nga kjo dispozitë e aplikuar rrjedh se ankesa është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.
15. Lidhur me pronësinë e Palës Ankuese mbi objektin banesor të ndërtuar me mjetet e veta Gjykata Supreme gjeti se çdo lloj kompensimi eventual i dëmit bie jashtë Juridiksionit të KKPK-së.
16. Rrjedhimisht, ankesa e Palës Ankuese refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i ankimuar i KKPK-së vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligjin e zbatuar si duhet, në përputhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 paragrafi 1(d) i Ligjit për Procedurën Kontestimore, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.
17. Ky aktgjykim nuk konfirmon asnjë të drejtë mbi pronën për shfrytëzuesit momental e as që e paragjykon të drejtën e Palës Ankuese që ta referojë kërkesën për përfshirje në skemën e qirasë apo në gjykatën kompetente jashtë juridiksionit të paraparë me dispozitat e nenit 3.1 të Ligjit nr 03/L-079.
18. Në bazë të lartëcekurave, është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Beshir Islami, Gjyqtar

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it